

... të fëmijëve në transmetime
... esën e Autoritetit të Med
... ive që prej muajit prill ka
... tur më **Buletini i** shumë
... mendime **Lëshillit të** për
... cilave kanë **Ankesave.** "N
... të drejtë të kërkojë, të het
... të marrë dhe të ndajë info
... dhe ide, pa asnjë lloj censu
... dios, tu dhe mjeteve të tjer
... ikimit audioviziv apo ndor
... tjetër bazuar në përzgjed
... m nëse këtë e bën në kuad
... timit të sundin
... tave të njeriut.
... me krijimin e shërbimeve



AUTORITETI I
MEDIAVE
AUDIOVIZIVE

NR. 3

Dërbajtja

Hyrja	04
Procesi i trajtimit të ankesave nga Këshilli i Ankesave	06
SEKSIONI I	
Ankesa me subjekt cenimi i të drejtave të fëmijëve	09
SEKSIONI II	
Ankesa me subjekt cenimi i rregullave të etikës	22
SEKSIONI III	
Ankesa me subjekt komunikimet me natyrë tregtare	31
SEKSIONI IV	
Ankesa të tjera	37
SEKSIONI V	
Ankesat e rrëzuara	41

Dy fjalë

në vend të hyrjes

Konvergenca mes medias dhe teknologjisë në rendin e ri global po ndryshon. Çdo ditë e më shumë mënyrën me të cilën ne mësojmë mbi botën duke sfiduar madje bindshëm dhe vetë themelet e arsimit. Nuk është më e mjaftueshme që sot njerëzit vetëm të lexojnë ato që na ofrohen në shtypin e përditshëm, mediat online dhe në çdo gjë tjetër që i përket teknologjisë të së ardhmes. Fëmijët, të rinjtë dhe të rriturit kanë nevojë sot mbi të gjitha për të nxitur aftësinë për të interpretuar në mënyrë kritike imazhet e fuqishme që përmbysin çdo minutë një kulture multimediale. Arsimimi mbi njohuritë për median parashikon në kuadër të draft-planit të tij, një strukturë parapërgatitore dhe pedagogjinë që nevojitet për të edukuar qytetarët me njohjet e reja në shekullin e 21-të. Për më tepër, ky lloj këndvështrimi i ri kritik mbi median i hap rrugën zotërimit të aftësive të duhura për të mësuar më shumë e vazhdimisht në një botë gjithëherët në ndryshim.

Mbi të gjitha *Edukimi për Median* është aftësia e qytetarëve për të përdorur, kuptuar dhe për të marrë pjesë efektivisht e në mënyrë të ndërgjegjshme në të gjitha format e komunikimit, si pjesë e një procesi demokratik në të cilën gjendet Shqipëria megjithëse në kushtet e një tranzicionit të gjatë.

Sfidat e një bote multimediale

Që prej kohëve më të hershme, koncepti "alfabetizëm" do të thoshte të ishte në gjendje të interpretojë "dykuptueshmëritë" mes fjalëve, vec e vec apo kur ato formësoheshin në një shprehje letrare dhe jo vetëm. T'u mësoje të rinjve të dëshifrojnë këto shprehje të cilat bëheshin gjithmonë e më komplekse në paraqitjen e ideve, u bë qëllimi më i lartë i edukimit të tyre përgjatë shumë shekujve histori.

Sot, informacioni në lidhje me botën na vjen rreth nesh jo vetëm me fjalë apo nëpërmjet një njoftimi për shtyp, por gjithnjë e më shumë përmes imazheve të fuqishme dhe tingujve të kulturës sonë multi-mediale. Që nga momenti kur celulari na bën zgjimin e derisa ne vendosim të flemë ndërsa jemi duke ndjekur një *talk-show* natën vonë, jemi vazhdimisht të ekspozuar

ndaj qindra e mijëra imazheve, informacioneve, mendimeve, platformave etj., jo vetëm nga televizioni, por edhe nga faqet e internetit, filmat, radioja, kopertinat, posta elektronike, video gamës, mesazheve telefonike, posterave apo dhe më shumë. Media nuk formëson më vetëm kulturën tonë ... Ajo jemi Ne.

Edhe pse informacionet që vijnë on-line mund të duken se janë të qarta, në të vërtetë, ato mbajnë brenda mesazhe komplekse në audio dhe video brenda një gjuhe e cila ka nevojë të deshifrohet. Jo çdo gjë mund të jetë e qartë që në fillim; imazhet në këtë botë të re teknologjike vrapojnë shumë më shpejt tek audienca! Shpejtësia e saj është aq e madhe se njeriu po gjendet krejt i papërgatitur ta lexojë atë sic duhet pikërisht për shkak të mungesës së njohurive për këtë lloj të re media. Nëse fëmijët tanë do të jenë të aftë për të lundruar përmes kësaj kulture multimediale, ata duhet të jenë mjaftueshëm të arsimuar në "leximin" dhe "shkrimin" e një gjuhe të re që po lind sot në botë, gjuha e imazheve dhe tingujve, ashtu siç i kemi mësuar atyre të "lexojnë" dhe "të shkruajnë" gjuhën e mjeteve të komunikimit.

Sot në botë, ekspertë të huaj të medias e quajnë brezin e ri, si "brezi i ekranit" sepse përdorimi i medias nga ana e tyre pavarësisht se cfarë ekrani përdorin, televizion apo video games/ filma/ kompjuter por qoftë edhe telefonë është një lloj komunikimi i vazhdueshëm që evoluon në një rrugë të pandalshme. Kjo lloj mundësie nga ana tjetër, ka transformuar përdorimin dhe ndikimin e mediave në jetën tonë të përditshme:

'Brezi i ekraneve' e sheh median jo më si një produkt diskret nga ku mund të ndikohen ata vetë apo kultura e tyre, por si një prej elementëve të një mozaiku multi-medial.

'Brezi i ekraneve' sot "lexon" dhe "shkruan" ndoshta në mënyrë të pakuptimtë tekste të tëra por ama përdorur si asnjëherë më mirë imazhet, tingujt dhe fjalët.

Dhe në fund 'brezi i ekraneve' e jeton rendin e ri botëror jo më në kufijtë e saj fizike, por si një rrjet global i kontakteve gjithëherët online që nuk pushojnë kurrë së bashkë vepruari.

Procesi i trajtimit të ankesave nga Këshilli i Ankesave

Mbështetur mbi Ligjin nr. 97/ 2013 për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë dhe Kodit të Transmetimit, shikuesit dhe dëgjuesit e subjekteve audiovizive kanë të drejtën të ankohen rreth përmbajtjes së transmetimeve audiovizive, nëse ata besojnë dhe mendojnë që subjektet kanë cenuar apo shkelur parimet dhe rregullat etike, të hartuara në Ligjin Nr. 97/2013 dhe ato në Kodin e Transmetimit.

Por që të mund të ngrihet një ankesë duhet të identifikohet më parë programi apo emisioni, të cilit ankesa i referohet, duke përfshirë datën dhe kohën e transmetimit. Gjithashtu, ankuesi duhet të shpjegojë se çfarë cenimi/shkelje ka vërejtur në përmbajtjen e programit që e ka detyruar atë të ngrejë një ankesë.

Është shumë e rëndësishme të përcaktohen qartësisht argumentet e një ankesë dhe përse materiali programor apo përmbajtja komerciale nuk pajtohet me parimet, rregullat, kërkesat dhe praktikën e përcaktuara në Ligjin nr. 97/2013 dhe në Kodin e Transmetimit. Ligji për mediat audiovizive dhe Kodi i Transmetimit mund të gjenden në faqen zyrtare të AMA-s: www.ama.gov.al.

Në një nga seksionet e kësaj faqeje, pasi të klikoni në rubrikën "Formular ankesë për shkeljen e Kodit të Transmetimit", plotësoni formularin me të dhënat që kërkohen ose mund të shkruani në adresën zyrtare të AMA-s: info@ama.gov.al. Në përputhje me procesin e ankimit, shikuesi apo dëgjuesi duhet të dërgojë ankesën në adresën që gjendet në fund të fletës së ankesës, pasi ka lexuar me kujdes udhëzimet për hartimin e saj, por mbi të gjitha parimet dhe rregullat e Kodit të Transmetimit.

Në disa raste, publiku vetë mund t'ua drejtojë OSHMA-ve ankesat që ai harton, kur e mendon se kjo është një rrugë më e shpejtë dhe që subjekti mund të reflektojë. Kur shikuesi apo dëgjuesi nuk mbetet i kënaqur me përgjigjen nga transmetuesit ose, nëse transmetuesi nuk përgjigjet, atëherë ai mund ta referojë ankesën e tij në Këshillin e Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, në faqen e tij zyrtare ose me postë.

Sa i përket trajtimit të ankesës, Këshilli i Ankesave në shqyrtimin e çdo ankesë që i mbërrin, bazohet mbi kodet dhe rregullat përkatëse në ligj, në materialin e shkruar të paraqitur nga palët përkatëse, si dhe materialin e transmetimit. Ankesat shqyrtohen në nivel ekzekutiv nga Këshilli i Ankesave, në bashkëpunim me drejtorinë e tjera të AMA-s, si Drejtoria e Programeve, Drejtoria Juridike dhe ajo e Mbikëqyrjes.

Detajet e shqyrtimit dhe vendimet mbi ankesat për përmbajtjen e transmetimeve audiovizive të marra nga Këshilli i Ankesave janë publikuar në këtë dokument, i cili quhet *Buletini i Këshillit të Ankesave*. Vendimet merren mbi çështjen, nëse një program apo një komunikim tregtar ka apo nuk ka respektuar kërkesat përkatëse ligjore dhe rregullat e Kodit të Transmetimit. Vendimet nuk lidhen me miratimin apo përkrahjen që mund t'u bëhet palëve në ankesë dhe gjithashtu ato nuk vijnë si rezultat i trajtimit të çdo aspekti të detajuar që përmban vetë ankesa. Këshilli i Ankesave nuk kryen asnjë vlerësim të veçantë apo të pavarur jashtë çështjeve të parashtruara në ankesë.

1

Ankesa me
subjekt
cenimi i të
drejtave
të femijëve

Ankesa e paraqitur nga:

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Subjekti audioviziv

**News 24
Ora News
ABC News**

Programi

Edicion Informativ

Data

05.07.2017

1. Programi

Ankesa e Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve pretendon se në edicionet e lajmeve në 3 televizionet informative, News 24, Ora News dhe ABC News u transmetua një kronikë që në mënyrë indirekte çojnë në identifikimin e vajzës së mitur e dyshuar që është abuzuar nga i ati. Bëhet fjalë për rastin e një fëmije vetëm 5 vjeç, e cila sipas lajmit në media është abuzuar nga babai i saj.

2. Kategoria

Ankesa ngrihet mbi bazën e parimeve të sanksionuara në Konventën e OKB-së "Për të Drejtat e Fëmijës", Ligjin Nr. 18/2017 , "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve", Ligjit Nr. 97/ 2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë" dhe Kodit të Transmetimit (Seksioni 5: pikat 5.1 dhe 5.2).

3. Përmbledhje e Ankesës

Sipas ankesës, në kronikat e lajmeve të këtyre televizioneve është publikuar i plotë emri i babait abuzues, është intervistuar me zë dhe figurë dhe e identifikuar me emër, gjyshja e vajzës, janë transmetuar pamje nga banesa ku banon vajza e abuzuar. Gjithashtu është publikuar emri i rrethit dhe

fshatit ku banon fëmija i abuzuar si dhe janë publikuar detaje mbi abuzimin që i është bërë fëmijës. Publikimi i të dhënave që mund të identifikojnë fëmijën, mund të bëhet shkak që fëmija te ritraumatizohet dhe riviktimizohet dhe kjo mund bëhet shkak që të dëmtohet fëmija në të ardhmen.

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave shqyrtoi kronikat televizive gjatë edicioneve informative të përsëritura disa herë, në televizionet News 24, Ora News dhe ABC News.

Këshilli i Ankesave konstatoi se edhe pse identiteti i vajzës 5-vjeçare nuk është publikuar, identifikimi i saj bëhet i mundur në mënyrë të tërthortë, pasi:

- gjatë raportimit të lajmit janë publikuar emri dhe mbiemri i babait 36-vjeçar, i dyshuar për kryerjen e veprimeve të turpshme.
- në vijim të raportimeve për këtë ngjarje, në transmetimet tuaja ka patur edhe një intervistë me një të afërme të 36-vjeçarit të dyshuar, e cila është intervistuar me zë dhe figurë, nga banesa ku dyshohet të jetë abuzuar e mitura.
- është publikuar njësia administrative dhe emri i fshatit, ku ka ndodhur kjo ngjarje e dyshuar.

4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave konstatoi cenim të Kodit të Transmetimit të AMA-s, konkretisht të seksionit 1, "Parime Themelore", pikat 1.3, 1.4, 1.17, si dhe seksioni 5, "Fëmijët në transmetime audiovizive", pika 5.1, 5.2 dhe 5.3, për mosrespektim të të drejtave të të miturve në programet informative.

Këshilli i Ankesave konstatoi se, gjatë raportimit të këtij lajmi nuk janë respektuar as parimet e sanksionuara në Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara "Për të Drejtat e Fëmijës". Kjo Konventë, palë e së cilës është edhe Shqipëria, në nenin 16 të saj, "Mbrojtja e jetës private", përcakton: "Asnjë fëmijë nuk u nënshtrohet ndërhyrjeve arbitrare apo të paligjshme në jetën e tij private, në familje, në shtëpi ose në korrespondencën e tij".

Parimet themelore kërkojnë nga operatorët e shërbimit mediatik audioviziv, që gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tyre, të garantojnë dhe respektojnë lirinë e shprehjes dhe të drejtën e informimit. Në transmetimet e tyre audiovizive ato duhet të respektojnë personalitetin, dinjitetin dhe të drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut, në mënyrë të veçantë të drejtat, interesat dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve.

Gjithashtu, u rikujtua se Kodi i Transmetimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, Seksioni 5, "Fëmijët në transmetimet audiovizive", pika 5.1 detyron OSHMA-të të shmangin çdo raportim që çon drejtpërsëdrejti ose tërthorazi në identifikimin e fëmijëve: "OSHMA-të duhet të shmangin çdo raportim apo transmetim, që çon direkt apo indirekt në identifikimin me pamje dhe zë, me gjeneralitete, adresë apo përshkrues të çdo fëmije që mund të jetë ose është viktimë, dëshmitar, i hetuar, i akuzuar apo deklaruar fajtor për kryerjen e një veprë penale".

Sa më sipër, identifikimi i tërthortë i vajzës 5-vjeçare, ndaj së cilës dyshohet të ketë abuzuar seksualisht i ati, mund të shkaktojë dëmtime psikologjike me pasoja për të ardhmen e saj si dhe të pengojë rehabilitimin e saj pas traumës së shkaktuar.

Bazuar mbi Kodin e Transmetimit, AMA vendosi t'u tërheqë vëmendjen 3 televizioneve informative për të mos përsëritur raste të tilla. AMA kërkoi gjithashtu heqjen e videove përkatëse nga kanalet zyrtare në Youtube.

Vlen të përmendet se televizioni News 24 reagoi menjëherë përmes shkresës drejtuar AMA-s ku informonte se ka ndërprerë çdo mundësi për ritransmetimin e lajmit si dhe ka hequr nga Youtube videon përkatëse.

Ankesa e paraqitur nga:

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Subjekti audioviziv	Programi	Data
Televizioni News 24	Edicion Informativ	16.10.2017
Televizioni Ora News	Edicion Informativ	16.10.2017
Televizioni ABC News	Edicion Informativ	16.10.2017

1. Programi

Ankesa lidhet me publikimin e një lajmi në edicionet informative të këtyre subjekteve audiovizive, që transmetojnë edicione informative 24 orë në 24. Objekti mbi të cilin ngrihet ankesa është publikimi i të dhënave të ndjeshme lidhur me rastin e një vajze 15-vjeçare, viktimë e një abuzimi të dyshuar seksual.

2. Kategoria

Ankesa bazohet në parimet e sanksionuara në Konventën e OKB-së "Për të Drejtat e Fëmijës" dhe Ligjin Nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve", ku sanksionohet qartë ruajtja e konfidencialitetit dhe e privatësisë së fëmijës. Ankesa bazohet edhe në Ligjin nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", dhe mbi Kodin e Transmetimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, i ndryshuar, seksioni "Parime Themelore", pika 1.3, 1.4, 1.17 si dhe seksioni 5, "Fëmijët në transmetimet audiovizive", pikat 5.1 dhe 5.2 (garantimi i mbrojtjes së fëmijëve, e drejta absolute e fëmijës për privatësi).

3. Përmbledhja e ankesës

Nisur nga ngjarja e ndodhur në një fshat të Pogradecit, ku fajin dyshohet se ka abuzuar seksualisht një vajzë 15-vjeçare, e cila ka mbetur shtatzënë, Agjencia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve shpreh shqetësimin për mënyrën se si ky rast është publikuar në disa media audiovizive. Agjencia vëren se tre televizionet - News 24, Ora News dhe ReportTv - kanë publikuar lajmin në fjalë në kundërshtim me parimet e mbrojtjes së fëmijëve. Edhe pse emri i vajzës që dyshohet të jetë abuzuar seksualisht nuk është publikuar, identifikimi i saj bëhet në mënyrë të tërthortë, pasi janë transmetuar pamje dhe detaje identifikuese të shtëpisë, si dhe janë dhënë edhe detaje të panevojshme për fshatin dhe rrethin ku banon vajza.

Bazuar sa më sipër, ankuesi vë në dukje se publikimi i lajmit mbi abuzimin seksual të 15-vjeçares në tre televizionet - News 24, Ora News dhe ReportTv - përbën shkelje të të drejtave të fëmijëve, përfshirë këtu veçanërisht, të drejtën e konfidencialitetit dhe tëprivatësisë së fëmijëve.

4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mori në shqyrtim materialet përkatëse filmike, të shfaqura në tre televizionet për raportimin e lajmit në fjalë, dhe konstatoi shkelje të Kodit të Transmetimit.

Këshilli i Ankesave çmoi që, edhe pse identiteti i vajzës nuk është publikuar, edhe pse gjatë intervistës fytyra e saj është e mbuluar, identifikimi i saj bëhet i mundur në mënyrë të tërthortë. Gjatë intervistës së kryer brenda banesës së 15-vjeçares, janë transmetuar pamje dhe detaje identifikuese të shtëpisë, nga brenda dhe jashtë saj. Gjithashtu, gjatë intervistimit janë dhënë edhe detaje për fshatin dhe rrethin ku banon vajza, ndaj së cilës është kryer abuzimi seksual. Bashkë me vajzën, gjatë intervistës janë identifikuar nëna, babai dhe gjyshja e fëmijës. Në prani të 15-vjeçares së abuzuar është intervistuar dhe identifikuar plotësisht, para kamerës, nëna e saj, duke mundësuar në këtë mënyrë edhe identifikimin e vajzës. Kodi i Transmetimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, Seksioni 5, "Fëmijët në transmetimet audiovizive", pika 5.1, detyron OSHMA-të të shmangin çdo raportim që çon drejtpërsëdrejti ose tërthorazi në identifikimin e fëmijëve: "OSHMA-të duhet të shmangin çdo raportim apo transmetim, që çon direkt apo indirekt në identifikimin me pamje dhe zë, me gjeneralitete, adresë apo përshkrues të çdo fëmije që mund të jetë ose është viktimë, dëshmitar, i hetuar, i akuzuar apo deklaruar fajtor për kryerjen e një vepre penale".

Gjatë intervistimit të vajzës 15-vjeçare, edhe pse në prani të psikologut, janë shkelur të drejtat e fëmijës për ruajtje të konfidencialitetit dhe privacisë, si dhe është dëmtuar dinjiteti i fëmijës viktimë. Fëmija është pyetur dhe ka treguar për detaje të abuzimit, në kushte të rënduara psikologjike.

Edhe mënyra e raportimit të lajmit, duke intervistuar drejtpërdrejt vajzën dhe familjarët

e saj, është në shkelje të dinjitetit dhe të të drejtave të fëmijës. Kjo shkelje përsëritet më tej me intervistimin e nënës së 15-vjeçares, e cila ka treguar e tronditur, në prani të vajzës së saj, detaje të abuzimit, që e kanë rënduar edhe më shumë situatën gjatë intervistës. Seksioni 1 i Kodit të Transmetimit, Parimet Themelore, në pikat 1.3 dhe 1.4, sanksionojnë qartësisht se "Transmetimet audiovizive respektojnë personalitetin, dinjitetin dhe të drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut" si dhe "Veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton në mënyrë të veçantë të drejtat, interesat dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve".

Këshilli i Ankesave konstatoi se, gjatë raportimit të këtij lajmi nuk janë respektuar as parimet e sanksionuara në Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara "Për të Drejtat e Fëmijës". Kjo Konventë, palë e së cilës është edhe Shqipëria, në nenin 16 të saj, "Mbrojtja e jetës private", thuhet shprehimisht: "Asnjë fëmijë nuk u nënshtrohet ndërhyrjeve arbitrare apo të paligjshme në jetën e tij private, në familje, në shtëpi ose në korrespondencën e tij".

Bazuar sa më sipër, Këshilli i Ankesave çmoi se, nuk ka asnjë interes publik që justifikon intervistimin dhe publikimin e detajeve të jetës së 15-vjeçares së abuzuar dhe të vetë abuzimit. Nga ana tjetër, identifikimi i tërthortë i vajzës, ndaj së cilës është kryer abuzimi seksual, mund të shkaktojë dëmtime psikologjike me pasoja për të ardhmen e vajzës dhe të pengojë rehabilitimin e saj pas traumës së shkakuar. Këshilli i Ankesave vendosi t'u tërheqë vëmendjen tre operatorëve audiovizivë, bazuar mbi Ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" dhe në Kodin e Transmetimit të AMA-s, i ndryshuar, duke u rikujtuar gjithashtu se, mbrojtja e interesit më të lartë për fëmijën duhet të jetë parimi mbizotërues që duhet të udhëheqë punën e medias para çdo interesi tjetër. Gjithashtu, AMA u kërkoi edhe heqjen e videove përkatëse nga kanalet e tyre zyrtare në Youtube.

Ankesa e paraqitur nga:

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Subjekti audioviziv

Televizioni News 24

Programi

Edicion Informativ

Data

11.11.2017

1. Programi

Ankesa lidhet me publikimin e një lajmi në edicionet informative të këtyre subjekteve audiovizive, që transmetojnë edicione informative 24 orë në 24. Objekti mbi të cilin ngrihet ankesa është publikimi i një lajmi mbi abuzimin seksual të një vajze 13 vjeçareku megjithëse identiteti i vajzës nuk është publikuar, identifikimi i saj bëhet i mundur në mënyrë të tërthortë.

2. Kategoria

Ankesa bazohet në parimet e sanksionuara në Konventën e OKB-së "Për të Drejtat e Fëmijës" dhe Ligjin Nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve", ku sanksionohet qartë ruajtja e konfidencialitetit dhe e privatësisë së fëmijës. Ankesa bazohet edhe në Ligjin nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", dhe mbi Kodin e Transmetimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, i ndryshuar, seksioni "Parime Themelore", pika 1.3, 1.4, 1.17 si dhe seksioni 5, "Fëmijët në transmetimet audiovizive", pikat 5.1 dhe 5.2 (garantimi i mbrojtjes së fëmijëve, e drejta absolute e fëmijës për privatësi).

3. Përmbledhja e ankesës

Nisur nga ngjarja e ndodhur në një fshat të Sarandës, ku një 22 vjeçar ka abuzuar seksualisht një vajzë 13-vjeçare, Agjencia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve shpreh shqetësimin për mënyrën se si ky rast është publikuar megjithëse identiteti i saj nuk është publikuar.

Agjencia vëren se nga monitorimi i medias, është konstatuar një lajm i abuzimit seksual të një fëmije 13 vjeçar, nga një 22 vjeçar. Nga këtej është konstatuar që televizioni NEËS 24 ka publikuar lajmin në shkelje të të drejtave të fëmijës. Edhe pse identiteti i vajzës vëren Agjencia nuk është publikuar, identifikimi i saj bëhet i mundur në mënyrë të tërthortë sepse gjatë raportimit të lajmit është publikuar emri dhe mbiemri i nënës së fëmijës, viktimë e abuzimit seksual; është intervistuar nëna dhe babai i vajzës me zë dhe figurë; është publikuar njësia administrative dhe emri i fshatit ku ka ndodhur ngjarja; janë publikuar pamje të lagjes ku banon vajza abuzuar.

Sipas saj, mënyra e raportimit të lajmit duke intervistuar drejtpërdrejt familjarët e saj dhe duke raportuar detaje të abuzimit është në shkelje të dinjitetit dhe të të drejtave të fëmijës. Raportimi fokusohet në detaje të ngjarjes, duke anashkaluar problematikën e abuzimit të fëmijës.

Nuk ka asnjë informacion lidhur me të drejtat e fëmijës që shkelen dhe me mbrojtjen e vecantë që gëzojnë fëmijët duke përfshirë dhe mbrojtjen nga abuzimi seksual. Mënyra e raportimit m detaje që e bëjnë fëmijën të identifikueshëm lehtësisht në komunitet përbën barrirerë në stabilizimin dhe vazhdimësinë sa më normale të jetës së vajzës.

Agjencia thekson më tej se identifikimi në media i fëmijëve, viktimë të abuzimit seksual duhet evituar sa më shumë të jetë e mundur, pasi nuk është në interesin më të lartë të fëmijës, dhe nuk ka asnjë interes publik që justifikon intervistimin dhe publikimin e detajeve të jetës së fëmijës dhe të abuzimit.

Bazuar sa më sipër Agjencia kërkon që të merren masa të menjëhershme duke u mbështetur në ligjin për mediat audiovizive për këtë subjekt i cili pretendohet se ka shkelur të drejtat e fëmijëve.

4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Pas mbërritjes së kësaj ankesë Këshilli i Ankesave bazuar mbi procesverbalet e mbajtura me temë shqyrtimin e përmbajtjes së ankesës nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, arriti në këtë konkluzion:

për rastin në fjalë të publikimit të lajmit të abuzimit seksual të një 13 vjeçareje nga një i ri në në rrethin e Sarandës nga NEWS 24, konstatohet se ankesa qëndron bazuar mbi ligjet që ofrojnë mbrojtje dhe mbështetje të të drejtave të fëmijëve. Aty u vërejt se janë shkelur të drejtat e fëmijëve. Sa më sipër, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive vërejt gjithashtu se ka shkelje të Kodit të Transmetimit, edhe pse identiteti i vajzës nuk është publikuar. Megjithë këtë ekipi i KA vërejt se identifikimi i saj bëhet i mundur në mënyrë të tërthortë, pasi gjatë raportimit të lajmit është publikuar emri dhe mbiemri i nënës së 13-vjeçares. Nëna është intervistuar me zë dhe figurë, ashtu si edhe babai i saj, e cila dyshohet të jetë viktimë e një abuzimi seksual. Gjatë raportimit të lajmit janë dhënë, në mënyrë të panevojshme, edhe pamje nga njësia administrative, fshati dhe shtëpia ku banon vajza 13-vjeçare.

Kodi i Transmetimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, Seksioni 5, "Fëmijët në transmetimet audiovizive", pika 5.1, detyron OSHMA-të të shmangin çdo raportim që çon drejtpërdrejt ose tërthorazi në identifikimin e fëmijëve: "OSHMA-të duhet të shmangin çdo raportim apo transmetim, që çon direkt apo indirekt në identifikimin me pamje dhe zë, me gjeneralitete, adresë apo përshkrues të çdo fëmije që mund të jetë ose është viktimë, dëshmitar, i hetuar, i akuzuar apo deklaruar fajtor për kryerjen e një vepr penale".

Këshilli i Ankesave çmon gjithashtu se, mënyra e raportimit të lajmit në fjalë, duke intervistuar familjarët e së miturës, me zë dhe figurë, me identitete të plotë, shkel drejtpërdrejt dinjitetin dhe të drejtat e fëmijës. Raportimi i lajmit, me detaje të panevojshme për mënyrën e abuzimit të dyshuar seksual, në vend të informacioneve për të drejtat dhe mbrojtjen e veçantë që gëzojnë fëmijët, mund të shkaktojë dëmtime psikologjike me pasoja për të ardhmen e vajzës 13-vjeçare dhe të pengojë rehabilitimin e saj në të ardhmen. Seksioni 1 i Kodit të Transmetimit, Parimet Themelore, në pikat 1.3 dhe 1.4, sanksionojnë qartësisht se "Transmetimet audiovizive respektojnë personalitetin, dinjitetin dhe të drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut", si dhe "Veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton në mënyrë të veçantë të drejtat, interesat dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve".

Këshilli i Ankesave u rikujtoi edhe njëherë se, identifikimi në media i fëmijëve që janë viktimë të abuzimit seksual duhet shmangur sa herë të jetë e mundur, pasi nuk është në interesin më të lartë të fëmijës, dhe nuk ka asnjë interes publik që justifikon publikimin e detajeve të jetës së tij dhe të vetë aktit të abuzimit. Këshilli i Ankesave konstatoi gjithashtu se, gjatë raportimit të këtij lajmi nuk janë respektuar as parimet e sanksionuara në Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara "Për të Drejtat e Fëmijës". Në këtë Konventë, palë e së cilës është edhe Shqipëria, në nenin 16 të saj, "Mbrojtja e jetës private", thuhet shprehimisht: "Asnjë fëmijë nuk u nënshtrohet ndërhyrjeve arbitrare apo të paligjshme në jetën e tij private, në familje, në shtëpi ose në korrespondencën e tij".

Referuar sa më sipër dhe bazuar mbi Kodin e Transmetimit, Këshilli i Ankesave vendosi t'i tërheqë vëmendjen për të mos përsëritur raste të tilla e natyrisht edhe heqjen e videos përkatëse nga faqja online e subjektit dhe kanali zyrtar në Youtube.

Ankesa e paraqitur nga:

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Subjekti audioviziv

News 24

Programi

Me zemër të hapur

Data

3 Gusht 2017

1. Programi

Ankesa e Agjencisë ka të bëjë me një video amatore e të fshehtë të transmetuar në emisionin "Me zemër të hapur" në News 24, më datë 28.07.2017. Në qendër të emisionit ishin marrëdhëniet intime të një nëne, e cila, siç shpjegohej me titra të dukshme, "kryen veprime të turpshme në sy të fëmijëve". Për ilustrimin e asaj që ka ndodhur, gjatë emisionit janë përdorur regjistrime amatore dhe të paqarta, të kryera brenda një mjedisi familjar. Autoriteti i Mediave Audiovizive reagoi me anë të një njoftimi për shtyp për rastin në fjalë.

2. Kategoria

Ankesa ngrihet mbi bazën e parimeve të sanksionuara në Konventën e OKB-së "Për të Drejtat e Fëmijës", Ligjin Nr. 18/2017, "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve", Ligjit Nr. 97/ 2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë" dhe Kodit të Transmetimit (Seksioni 5: pikat 5.1 dhe 5.2).

3. Përmbledhje e Ankesës

Sipas pretendimit të Agjencisë, grindja që ndodh në video për një skandal seksual është kryer në prani të fëmijëve. Fëmijët prezent në këtë video janë të identifikueshëm, edhe pse video nuk është shumë e qartë dhe pamjet janë të sfumuara. Emri i nënës është identifikuar në media. Në ditët në vijim, i njëjti emision ka intervistuar gjyshin e fëmijëve dhe nënën e tyre, duke e bërë edhe më të qartë identifikimin e tyre në media.

Ngjarja e bujshme u publikua në shumë media të tjera elektronike duke shkaktuar tronditje dhe reagim të opinionit publik, lidhur me prezencën e fëmijëve dhe transmetimin e videos. Agjencia pretendon se publikimi i videos jo vetëm që ka shkelur privatësinë e fëmijëve, por i ka ekspozuar ata në skena të papërshtatshme për ta, duke dëmtuar rëndë imazhin e tyre. Publikimi i saj mund të behet shkak që fëmijët të ritraumatizohen, riviktimizohen dhe dëmtohen në të ardhmen.

4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave, pasi shqyrtoi emisionin "Me zemër të hapur", të transmetuar në televizionin "Tv News 24", më datë 28.07.2017, konstatoi se ky transmetim binte ndesh me kërkesat e ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të Kodit të Transmetimit. Për këtë arsye, Këshilli i Ankesave vendosi sanksionin me gjobë në masën 200.000 (dyqind mijë) lekë ndaj operatorit televiziv në fjalë.

Pas njoftimit të sanksionit me gjobë, shoqëria "Focus Media News" sh.p.k., me shkresën, administruar në Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA) me nr. 2620/1 prot., datë 22.08.2017, depozitoi ankimin administrativ. AMA mori në shqyrtim ankimin e paraqitur nga shoqëria "Focus Media News" sh.p.k., licencuar për televizionin privat vendor "Tv News 24", ndaj sanksionit gjobë.

Duke iu referuar ankimit të paraqitur, i cili bën një përmbledhje të të gjithë kronologjisë së transmetimit, AMA konstaton se:

- Ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, kërkon nga operatorët që, në përmbajtjet e transmetuara prej tyre të mos cenojnë dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut dhe, gjithashtu, të mos cenojnë të drejtën e fshehtësisë së jetës private të individit.

Lidhur me pretendimin e ngritur prej palës ankuese, AMA vlerëson se, pavarësisht se zj. Lule Nacaj nuk pretendon shkelje të dinjitetit të saj apo cenim të jetës private, transmetimi i videos nuk e justifikon subjektin audioviziv prej cenimit të dinjitetit të njeriut dhe privatësisë së tij. Këshilli i Ankesave, i qëndron argumentit se, transmetimi i videos në një mjedis familjar përbën një precedent të rrezikshëm për shkelje të dyfishtë: të dinjitetit dhe jetës private të njeriut.

Pavarësisht nga shpjegimet e subjektit

ankues mbi kronologjinë e këtij rasti dhe të transmetimit të tij për publikun, AMA gjykon se nuk kemi të bëjmë me interes publik, që të përligjte transmetimin e videos në fjalë. Edhe nëse për Televizionin "News 24" ky rast kishte sadopak interes publik, duhej të kishte gjetur mënyrën për t'a trajtuar çështjen, pa shkelur ligjin dhe parimet e Kodit të Transmetimit.

Sjellim në vëmendje se, në nenin 33, pikat "ç" dhe "dh" të ligjit nr. 97/2013 i sipërcituar, parashikohet se:

"1. Ofruesi i shërbimit mediatik audioviziv duhet: ...

ç) të mos cenojë dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut; ...

dh) të mos cenojë të drejtën e fshehtësisë së jetës private të individit në çdo program të transmetuar nga OSHMA-të ...".

Gjithashtu, edhe në Kodin e Transmetimit, Seksioni 2, "E drejta për privatësi në transmetimet audiovizive", në pikat 2.2 dhe 2.4, përcaktohet qartësisht:

"...OSHMA-të, në transmetimet e programet e tyre, nuk duhet të bëjnë publike imazhe, pamje, filmime, dokumente apo fotografi, që përmbajnë të dhëna personale apo cenojnë dinjitetin e individit, përveçse me miratimin e tij".

"...OSHMA-të mund të transmetojnë filmime, imazhe dhe informacione nga mjedise private, shtëpi, spitale, burgje, institucione të tjera rehabilitimi, vetëm me pëlqimin e personave të përfshirë."

Këshilli i Ankesave, konstatoi se nuk është marrë pëlqimi i nënës që është në qendër të videos së transmetuar, e konfirmuar kjo dhe nga intervistat e saj pas publikimit të ngjarjes. Këshilli i Ankesave i qëndron argumentit se, gjatë emisionit në fjalë janë shkelur në mënyrë të dukshme disa nga parimet themelore të Kodit të Transmetimit për respektimin në

mënyrë të veçantë të të drejtave, interesave dhe kërkesave morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve.

Po ashtu, shoqëria "Focus Media News" sh.p.k., pretendon se, dy të miturit që janë shfaqur në fotografi gjatë transmetimit kanë qenë të mbuluar dhe imazhi i tyre, është plotësisht i pidentifikueshëm. Por, na duhet të theksojmë se identifikimi i dy të miturve është tërësisht i lehtë, pasi:

- Identifikohet me emër e mbiemër i ati, me fotografi dhe në telefon;
- Identifikimi i tyre bëhet edhe nga emri i familjarëve, nga vendi i banimit të së ëmës, si dhe nga identifikimi i plotë dhe i qartë i gjyshit të tyre, i cili ishte i ftuar në studio.

Theksojmë gjithashtu se, shfaqja e përsëritur e fotove të të dy të miturve ishte tërësisht e panevojshme.

Duke iu rikthyer publikimit të videos, zërat, britmat dhe të qararë e dy të miturve që dëgjohen në sfond, krijojnë premisa për të dëmtuar psikologjikisht dhe fëmijë të tjerë, të cilët ndjekin emisionin në atë orar transmetimi (12:08 deri në orën 13:25).

Ashtu si ligji organik edhe Kodi i Transmetimit parashikojnë si detyrim që OSHMA-të jenë shumë të kujdesshëm në raportimet apo transmetimet e tyre, kur në to janë të përfshirë të mitur.

Konkretisht, në Seksionin 5 të Kodit të Transmetimit, "Fëmijët në transmetimet audiovizive", pikat 5.1 dhe 5.2, përcaktohet qartë se: "OSHMA-të duhet të shmangin çdo raportim apo transmetim, që çon direkt apo indirekt në identifikimin me pamje dhe zë, me gjeneralitete, adresë apo përshkrues të çdo fëmije që mund të jetë ose është viktimë, dëshmitar, i hetuar, i akuzuar apo deklaruar fajtor për kryerjen e një veprë penale", si dhe "Duhet shmangur çdo raportim apo

transmetim që çon direkt apo indirekt në identifikimin e çdo fëmije që mund të jetë ose është përfshirë në një ngjarje të rëndë familjare".

Publikimi i videos përfshin dy të mitur, të cilët janë pjesë e një ngjarjeje të rëndë familjare, si dhe i identifikon ata në mënyrë të tërthortë. Lidhur me pretendimin se, videoja në fjalë ishte hedhur në rrjetin social Facebook para se t'a publikonte Televizioni, përsëri kjo nuk e përlligj këtë të fundit nga shkelja e ligjit për mediat dhe parimeve të Kodit të Transmetimit, i cili përcakton qartë detyrimet e OSHMA-ve. AMA thekson se po ashtu nuk është i bazuar pretendimi i palës ankuese mbi konfliktet gjyqësore, civile, apo problemet midis palëve të cilat bien jashtë fushës së kompetencave të autoritetit rregullator. Megjithatë, AMA duke mbajtur në konsideratë disa nga rrethanat e çështjes, kryesisht mbrojtjes së të miturve objekt i kësaj video, arrin në përfundimin se masa e sanksionit gjobë duhet të rishikohet.

Për këto arsye, Autoriteti i Mediave Audiovizive, në bazë të nenit 19, pika 16, nenit 33, pikat "ç" dhe "dh" dhe nenit 133, pika 1/a, të ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe nenit 137/4 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", vendosi:

- Pranimin e pjesshëm të ankimit administrativ të shoqërisë "Focus Media News" sh.p.k., duke ndryshuar masën e sanksionit gjobë të datës 03.08.2017, të vendosur ndaj subjektit televiziv privat vendor "Tv News 24", nga "200 000 lekë" në "100 000 lekë".
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë, në përputhje me ligjin nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", duke filluar dita e marrjes dijeni.
- Ngarkohet administrata e AMA-s për veprime të mëtejshme sipas ligjit.

Ankesa e paraqitur nga:

Këshilli i Ankesave

Subjekti audioviziv

Programi

Data

**Report TV
Klan Plus TV**

Lajme

29.09. 2017

1. Programi

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, konstatoi se në dy televizione (Report Tv dhe Klan Plus TV) u transmetua një intervistë me një fëmije në moshën 16 vjeçare, mbi një ngjarje të rëndë që ka ndodhur në familjen e tij. Kjo përmbajtje nuk respekton kërkesat e ligjit nr. 97/ 2013 për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë (të ndryshuar) dhe të akteve nënligjore të Kodit të Transmetimit. Autoriteti i Mediave Audiovizive reagoi me anë të një njoftimi për shtyp për rastin në fjalë duke vënë në dukje shkeljen e ligjit dhe të Kodit të Transmetimit.

2. Kategoria

Ankesa ngrihet mbi bazën e parimeve të sanksionuara në Konventën e OKB-së "Për të Drejtat e Fëmijës", Ligjin Nr. 18/2017 , "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve", Ligjit Nr. 97/ 2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë" dhe Kodit të Transmetimit (Seksioni 5: pikat 5.1 dhe 5.2).

3. Përmbledhje e ankesës

Gjatë kësaj interviste fëmija shpjegon në studio rrethanat e ngjarjes, ndërsa në ekran shfaqet imazhi fotografik i plotë i tij, gjeneralitetet e plota si dhe transmetimi shoqërohet me komente të detajuara aspak të përshtatshme të tilla si; "djali i gruas së vrarë", apo "Bashkim Mekolli vrau gruan me sqepar dy ditë më parë".

4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave konstatoi shkelje në Ligjin Nr. 97/ 2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë" dhe Kodit të Transmetimit dhe tërhoqi vëmendjen ndaj dy OSHMA-ve.

Në nenin 33 të ligjit, për detyrimet e OSHMA-ve, në pikën d) sanksionohet se OSHMA-të duhet "të respektojnë rregullat e etikës dhe moralit publik dhe të mos transmetojnë programe që mund të nxisin vepra penale", ndërsa në pikën dh) të po këtij ligji, thuhet më tej se "OSHMA-të duhet të mos cenojnë të drejtën e fshehtësisë së jetës private të individit në çdo program të transmetuar dhe mjetet e përdorura për të realizuar këto programe".

Gjithashtu, u ritheksua se Kodi i Transmetimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, Seksioni 5, "Fëmijët në transmetimet audiovizive", pika 5.1 detyron OSHMA-të të shmangin çdo raportim që çon drejtpërsëdrejti ose tërthorazi në identifikimin e fëmijëve. Aty thuhet se; "OSHMA-të duhet të shmangin çdo raportim apo transmetim, që çon direkt apo indirekt në identifikimin me pamje dhe zë, me gjeneralitete, adresë apo përshkrues të çdo fëmije që mund të jetë ose është viktimë, dëshmitar, i hetuar, i akuzuar apo deklaruar fajtor për kryerjen e një veprë penale".

Njëkohësisht, paragrafi i Kodit të Transmetimit që sanksionon parimet për intervistimin e fëmijëve nuk është respektuar. Pika 5.11 e Kodit të Transmetimit thotë se

"Fëmijës si dhe përfaqësuesit ligjor duhet t'i shpjegohet paraprakisht qëllimi i intervistës, si dhe përdorimi i mundshëm i saj. Si për fëmijën, ashtu edhe për përfaqësuesin ligjor, duhet të respektohet e drejta e tyre për të mos pranuar të intervistohen". Gjatë kësaj interviste nuk ka pasur asnjë përfaqësues ligjor të fëmijës si dhe transmetimi i kësaj interviste nuk duhej lejuar përse kohë fëmija është dëshmitar (ai përmend gjatë intervistës se është telefonuar nga autori pak para ngjarjes) në konfliktin e përmendur. Si rezultat i kësaj interviste, i mituri mund të ketë pasoja të rënda psikologjike.

Përse më sipër, Autoriteti i Mediave Audiovizive u tërhoqi vëmendjen për zbatimin e plotë të Ligjit për Mediat dhe akteve nënligjore të Kodit të Transmetimit.

AMA kërkoi gjithashtu heqjen e videos përkatëse nga llogaria juaj zyrtare në Youtube.

Në kundërshtim të kësaj mase, kryeredaktori i Klan Plus TV përligji dhënien e intervistës dhe kërkoi mirëkuptimin e AMA-s. Në përgjigje të tij, Autoriteti theksoi se *"pa vënë në dyshim qëllimet tuaja pozitive, rasti në fjalë nuk përbën interes publik përse kohë që krimi kishte ndodhur dhe intervista në median tuaj nuk përlijt aspak pasojat që fëmija mund të ketë në të ardhmen. Në vlerësim të përgjigjes tuaj, AMA rithekson se intervistimi i një fëmije ku në familjen e tij ka ndodhur një krim i rëndë, nuk përbën aspak interes publik"*.



Ankesa e paraqitur nga: **shtetasi K.N.**

Subjekti audioviziv

Klan TV

Programi

Film artistik

Data

24.07.2017

Ankesa me
subjekt
"cënimi i
rregullave
të etikës"

1. Programi

Ankesa e qytetarit K.N është në lidhje me orarin dhe përmbajtjen e serialit turk "Ertugrul" transmetuar në televizionin Klan. Sipas qytetarit, seriali përmban skena të rënda me prerje kokash dhe pamje trupash të ekzekutuar. Ai pretendon se orari i transmetimit të serialit që nis nga ora 20.00 nuk është i përshtatshëm dhe shpreh shqetësimin se fëmija i tij ka parë këto skena të papranueshme për moshën e saj.

2. Kategoria

Ankesa ngrihet mbi bazën e parimeve të sanksionuara në Ligjin Nr.97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë" dhe Kodit të Transmetimit, që përfshin seksionin nr 5 për Fëmijët në Transmetimet Audiovizive.

3. Përmbajtja e ankesës

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave shqyrtoi pretendimet e qytetarit në lidhje me përmbajtjen e serialit si dhe orarin e transmetimit. Seriali jepet pas orës 20.00 dhe shoqërohet gjatë gjithë kohës me shenjën paralajmëruese me ngjyrë të verdhë, që kërkon ndjekjen e tij vetëm në prani të prindërve.

4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave i bëri të ditur qytetarit se në lidhje me serialin në fjalë ka marrë disa ankesa. Sipas Kodit të Transmetimit, programet që mund të dëmtojnë fëmijët duhet të jepen pas orës 21.00. Shënim(Kodi i Transmetimit i rishikuar ka përcaktuar orën 22.00). Nëse një program jepet para kësaj ore, televizioni duhet të marrë masa teknike që fëmijët të mos i shikojnë apo dëgjojnë programe të tilla. Në rastin në fjalë, seriali shoqërohet gjithnjë me shenjën paralajmëruese ngjyrë të verdhë duke paralajmëruar se fëmijët mund ta shohin vetëm në prani të prindërve të tyre.

Fatkeqësisht, në Shqipëri, ende nuk funksionon Komisioni i Vizionimit i parashikuar në ligjin për Kinematografinë i cili është organi kompetent për të dhënë vlerësimin për serialin nëse ai duhet të transmetohet ose jo, si dhe në çfarë kategorie mund të transmetohet.

Seriali "Ertugrul" i transmetuar në Televizionin Klan është një prodhim me temë historike. Gjithsesi, nga vlerësimet e bëra nga agjensitë e huaja ky serial ka vlerësime pozitive por gjithnjë këshillohet që fëmijët ta shohin vetëm me prezencën e prindërve. Këshilli i Ankesave do e ndjekë shqetësimin tuaj por mbetet një debat më i gjerë ku duhen përfshirë më shumë aktorë në lidhje me cilësinë e transmetimeve audiovizuale që shpesh vuajnë nga cilësia e duhur.

Ankesa e paraqitur nga: **shtetasi A.H.**

Subjekti audioviziv	Programi	Data
Star Plus TV	Film artistik	05.08. 2017

1. Programi

Ankesa e qytetarit A.H lidhet me transmetimin e një filmi në televizionin Star Plus në Shkodër në orën 21.00 që sipas tij kishte përmbajtjen të lartë dhune dhe erotike. Qytetari pretendon se orari është i papërshtatshëm për familjen ndërsa televizioni duhet ta transmetojnë në një orar tjetër nga ai i transmetimit

2. Kategoria

Ankesa ngrihet mbi bazën e parimeve të sanksionuara në Ligjin Nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë" dhe Kodit të Transmetimit.

3. Përmbledhje e ankesës

Këshilli i Ankesave mori në shqyrtim ankesën në lidhje me transmetimin e një filmi në datën 05.07.2017, në orën 21:00 në televizionin Star Plus. Pas shqyrtimit të materialit filmik, Këshilli i Ankesave konstatoi se mungonin shënjat paralajmëruese për programin film të transmetuar, të sanksionuara në Kodin e Transmetimit.

4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave vendosi t'i rikujtojë televizionin Star Plus se transmetimi i filmave që mund të çenojnë apo dëmtojnë fëmijët duhet të jepen vetëm pas orës 21:00 dhe

bazuar mbi Kodin e Transmetimit shoqëruar me shenjën paralajmëruese në një anë të ekranit. Kodi i Transmetimit përcakton edhe fashën e orarit ku përdorimi i shenjës është i detyrueshëm. Në pikën 5.42 thuhet se "Për programet që transmetohen në fashën orare 19:00 – 22:30, bëhet i detyrueshëm përdorimi i shenjave paralajmëruese për programet që çenojnë e dëmtojnë fëmijët".

Në pikën 5.46 përcaktohen edhe llojet e shenjave paralajmëruese;

"A. Shenjë paralajmëruese me ngjyrë të kuqe, për programe ose filma, që nuk duhet të ndiqen nga fëmijët, të cilat transmetohen vetëm pas orës 21:00, me skena të rënda dhune psikologjike e fizike, me skena seksi, me keqpërdorim të gjuhës, fjalorit dhe etikës së komunikimit.

B. Shenjë paralajmëruese me ngjyrë të verdhë, për programe ose filma, të cilat fëmijët duhet t'i ndjekin të shoqëruar nga të rriturit.

C. Shenjë paralajmëruese me ngjyrë të gjelbër, për programe ose filma me përmbajtje që mund të ndiqen nga të gjithë, përfshi edhe fëmijët".

Përsa më sipër, Autoriteti i Medias Audiovizive tërheq vëmëndjen për zbatimin e plotë të Kodit të Transmetimit, në veçanti me orarin dhe shenjat paralajmëruese.

Ankesa e paraqitur nga: **shtetasi J.K.**

Subjekti audioviziv	Programi	Data
Klan TV	Emisioni investigativ "Stop"	03.08. 2017

1. Programi

Ankesa e qytetares J.K lidhje me përmbajtjen e emisionit STOP në televizionin Klan. Sipas ankesës, dy drejtuesit e emisionit kanë përdorur një fjalor aspak të përshtatshëm ndaj dy vajzave balerina në emision duke e cilësuar si misogyni, bullizëm dhe mosrespektim i përkatësisë krahinore.

2. Kategoria

Ankesa ngrihet mbi bazën e parimeve të sanksionuara në Ligjin Nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë" dhe Kodit të Transmetimit. Ankuesja pretendon se dy drejtuesit e emisionit kanë dhunuar të drejtat e njeriut.

3. Përmbledhje e ankesës

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave mori në shqyrtim pamjet vizive të emisionit. Gjatë dialogut mes dy drejtuesve të emisionit, që lë të kuptohet se u drejtohet dy balerinave, janë përdorur fjalë si; kafshë.

Referuar dialogut të zbardhur mes dy drejtuesve të emisionit, që vijon si më poshtë:

A: Më të mirat në ven!

B: Më të mirat në vend!

A: Jo në këtë vend, VEN!

A: Po thuj mi faleminderit! Se falas e ke moj. Po thuj mi faleminderit!

B: Po ca të thotë mo ca të thotë! Ti e di që kafshët nuk flasin?! Nuk flasin Kafshët! Lëri! Nuk FLASIN!

A: Nga komplimenti do filloj të të vë epitete!

Të betohem! Ja!

B: Ore ti, kjo është ajo që na ndryshon Neeee, dmth njerëzve! Nga..... e lëre tashi.. E pra! Hë! Po ti moj hormovide, flet ti?! Thuaje një fjalë të madhe!

A: Jo ajo nuk flet, ajo s'spripëtinë!

B: Thuaje një fjalë të madhe! Shi shi kur të thotë Hipopotam! Fjalë e madhe!

AB: Radiostacioni! Ahahahahahahah OKAY!

4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave konstatoi cenim të Kodit të Transmetimit të AMA-s, pasi fjalori i përdorur çënon dinjitetin e njeriut.

Këshilli i Ankesave çmoi se pavarësisht natyrës së emisionit, investigativ dhe satirik, përdorimi i fjalëve si kafshë, dhunon të drejtat dhe çënon normat etike dhe Kodin e Transmetimit. Kodi i Transmetimit në seksionin 1, "Parime Themelore", pikat 1.3 sanksionon në mënyrë të qartë se "Transmetimet audiovizive respektojnë personalitetin dinjitetin dhe të drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut".

Gjithashtu, përdorimi i fjalëve që çenojnë direkt ose tërthorazi dinjitetin, personalitetin dhe të drejtat e njeriu, bie ndesh edhe me Ligjin Nr. 97/ 2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë" i cili në nenin 33 të tij, pika d) përcakton si një nga detyrat e OSHMA-ve "të respektojë rregullat e etikës dhe moralit publik".

Referuar sa më sipër, bazuar në Kodin e Transmetimit, AMA vendosi të tërheqë vëmëndjen për të mos përsëritur raste të tilla si dhe kërkoi heqjen e videos përkatëse nga kanali zyrtar në Youtube.

Ankesa e paraqitur nga: **shtetasi Q.P.**

Subjekti audioviziv	Programi	Data
Televizioni Report TV	Edicion informativ	10.10.2017

1. Programi

Ankesa lidhet me publikimin e një lajmi në edicionet informative të këtij subjekti audioviziv, që transmeton edicione informative 24 orë në 24. Objekti mbi të cilin ngrihet ankesa është publikimi i të dhënave të pasakta lidhur me një eksperiment kimik të kryer para viteve 1990.

2. Kategoria

Ankesa bazohet në Ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, që përcakton si një nga detyrimet për OSHMA-të të sigurojnë që trajtimi i ngjarjeve, përfshirë çështjet që janë tema të debatit publik, të jetë i drejtë për gjitha subjektet e interesuara në këto çështje".

3. Përmbledhja e ankesës

Duke iu referuar edicionit informativ të mëngjesit në Report Tv, të datës 23.07.2017, ankuesi pretendon se gjatë edicionit është transmetuar një lajm i zgjeruar në lidhje me një eksperiment kimik, të kryer para viteve 1990. Ankuesi thotë se, për shkak të detyrës së lartë që ka mbajtur në ato kohë, ai vetë ka qenë në krye të eksperimentit në fjalë dhe i di saktësisht të gjitha fazat e eksperimentit, si dhe rrethanat e tij. Zoti Q.P. pretendon se në videon e transmetuar për të ilustruar eksperimentin kimik (video e përgatitur nga ai vetë) figura dhe personaliteti i tij janë cenuar "për shkak të pasaktësive dhe falsifikimit

të fakteve". Ai kërkon t'i jepet mundësia për të publikuar në të njëjtin televizion faktet e rrethanat e vërteta, sipas tij, të eksperimentit kimik që ai ka drejtuar vetë para viteve 1990.

4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mori në shqyrtim ankesën e zotit Q. P. dhe materialin përkatës filmik. Këshilli i Ankesave, bazuar në Ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, çmoi se ankuesit i lind e drejta e përgjigjes nga televizioni ReportTv dhe krijimi i një hapësire për të paraqitur pretendimet e veta.

Neni 33 i ligjit për mediat audiovizive që sanksionon detyrimet e OSHMA-ve, në pikën b) të tij shprehet qartësisht se "OSHMA-të duhet të sigurojnë që trajtimi i ngjarjeve, përfshirë çështjet që janë tema të debatit publik, të jetë i drejtë për gjitha subjektet e interesuara në këto çështje dhe të paraqitet në mënyrë të vërtetë dhe të paanshme". Gjithashtu, edhe Kodi i Transmetimit përcakton detyrimet ndaj OSHMA-ve që, çdo informacion të jetë i vërtetë, i saktë dhe i balancuar. Pika 4.14 e Kodit të Transmetimit përcakton se "OSHMA-të duhet të respektojnë të drejtën e korrektimit dhe të përgjigjes, si dhe të drejtën e prezumimit të pafajësisë e të konfidencialitetit".

Në këto kushte, Këshilli i Ankesave çmon se ankuesit Q.P. i lind e drejta e përgjigjes nga televizioni dhe i kërkoi këtij të fundit t'i japë mundësinë ankuesit të paraqesë pretendimet e tij për çështjen e eksperimentit.

Ankesa e paraqitur nga: **A.H. i përfaqësuar nga av. V.H.**

Subjekti audioviziv	Programi	Data
Televizioni Ora News	Emisioni "Ju flet Moska"	23.10.2017

1. Programi

Ankesa lidhet me disa deklaramë të drejtuesit të emisionit "Ju flet Moska" ndaj z. Agron Hetoja, me detyrën e administratorit të shoqërisë Koorporata Elektroenergjetike Shqiptare - KESH sh.a. Objekti mbi të cilin ngrihet ankesa është cenimi dhe shkelja e dinjitetit dhe të të drejtave themelore të njeriut.

2. Kategoria

Ankesa bazohet në nenin 32, pika 4 e Ligjit nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ku përcaktohet se "OSHMA-të nuk duhet të transmetojnë programe me përmbajtje që të nxisin urrejtje mbi bazë racore, gjinie, fetare, etnike, kombëtare dhe çdo formë tjetër diskriminimi", si dhe në nenin 33, pika 1, germa ç) të të njëjtit ligj, ku sanksionohet se "Ofruesi i shërbimit mediatik audioviziv duhet të mos cenojë dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut".

3. Përmbledhja e ankesës

Ankuesi pretendon se gjatë emisionit "Ju flet Moska", të transmetuar në televizionin Ora News, më datën 16 tetor 2017, nën titullin "Ja si vjedh Agron Hetoja përmes tenderit në KESH", autori i këtij emisioni ka cenuar dhe shkelur dinjitetin e tij, përmes deklaramëve të rreme.

Gjithashtu, ankuesi thotë se emisioni në fjalë ka shkelur kërkesat ligjore dhe etike për përmbajtjen e programeve audiovizive dhe kërkon ndëshkimin me gjobë të televizionit në fjalë.

4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave mori në shqyrtim materialin përkatës filmik dhe konstatoi shkelje të Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe të Kodit të Transmetimit. Konkretisht, në minutën 07.30 të emisionit "Ju flet Moska", drejtuesi i këtij emisioni shprehet: "Mehmet Krasniqi është një mik i ngushtë i z. Agron Hetoja, drejtor ekzekutiv dhe administrator njëkohësisht. Pra, Mehmet Krasniqi është mik i ngushtë, udhëtojnë bashkë në Gjermani dhe e çon për qejfe, për kështu, në ato vendet që di ai...". Më tej, në minutën 11.48, drejtuesi i emisionit thotë: "Shikoni z. Agron Hetoja me vëmendje. Ky është një njëri pa CV, ka punuar në OJQ, ky s'ka asnjë lidhje me KESH-in... çfarë lidhje... as inxhinier elektrik, ka një diplomë për ekonomik dhe ka punuar në OJF".

Këshilli i Ankesave çmon se, bazuar dy referimeve të mësipërme, televizioni Ora News ka shkelur dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut, në këtë rast të z. Hetoja. Ligji nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në nenin 33 të tij, "Detyrimet e OSHMA-ve", në pikën 1, germa ç) përcakton qartësisht se "Ofruesi i shërbimit mediatik audioviziv duhet të mos cenojë dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut".

Edhe Kodi i transmetimit i Autoritetit të Mediave Audiovizive, në Seksionin 1 të tij, "Parimet Themelore", pika 1.3 sanksionon qartësisht se "Transmetimet audiovizive respektojnë personalitetin, dinjitetin dhe të drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut". Aludime të tilla, si "...e çon për qejfe, për kështu,

në ato vendet që di ai..." apo konstatime si "... është një njëri pa CV, ka punuar në OJQ, ky s'ka asnjë lidhje me KESH-in..."; shkelin dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut. Kjo shkelje rëndohet më tej, në mënyrë flagrante, në minutën 13.56 të emisionit. "Feliksët e Hamburgut janë një familje nga Gjakova që merret me biznes prostitucioni në Hamburg të Gjermanisë. A mos ka qenë gjë për qejf ky zoti Agron Hetoja..."; thotë drejtuesi i emisionit. Një qëndrim i tillë, me akuza që u duhen referuar organeve ligj-zbatuese, është në shkelje të etikës, dinjitetit dhe të drejtave themelore të njeriut.

Këshilli i Ankesave i rikujtoi operatorit televiziv ndaj të cilit u paraqit ankesa se, Kodi i Transmetimit ka për qëllim të sigurojë pavarësinë dhe paanësinë e veprimtarisë së televizioneve, duke synuar që ato të bëhen gjithnjë e më të ndërgjegjshme për rolin dhe përgjegjësinë e tyre në transmetimin e programeve, në përputhje me respektimin e liritë e të drejtave themelore të njeriut, me standardet dhe parimet etike e morale të shoqërisë... Seksioni 1, pika 1.3 i Kodit të Transmetimit shprehet qartë: "Transmetimet audiovizive respektojnë personalitetin, dinjitetin dhe të drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut".

Referuar Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe Kodit të Transmetimit, AMA vendosi t'u tërheqë vëmendjen operatorit televiziv për të mos përsëritur raste të tilla dhe i kërkoi heqjen e videove përkatëse nga kanali zyrtar në Youtube.

Ankesa e paraqitur nga: **Individ**

Subjekti audioviziv

Televizioni Fax News

Programi

Edicion Informativ

Data

10.11.2017

1. Programi

Ankesa ka të bëjë me publikimin e disa pamjeve të rënda të një individi i cili kish pësuar një aksident automobilistik. Objekti i ankesës është trajtimi i këtij rasti nga strukturat përkatëse me ndalimin e publikimit të këtyre planeve filmike.

2. Kategoria

Ankesa mbështetet në Ligjin Nr. 97/ 2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar si dhe mbi parimet themelore të Kodit të Transmetimit miratuar nga Autoriteti i Mediave Audiovizive.

3. Përmbledhja e ankesës

Një qytetare i është drejtuar adresës së info@ama.gov.al duke vezuar shqetësimin për publikimin e disa pamjeve të rënda të një personi gjatë një aksidenti që i është bërë. Ajo shpreh indinjatën e saj se si këto plane mund të publikohen pa asnjë normë etike gjatë gjithë edicioneve informative.

4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori menjëherë në shqyrtim transmetimin e një lajmi pranë televizionit Fax News i cili shfaqte me

pamje mbulim rastin e një aksidenti në rrugë. Konkretisht lajmi titullohej "aksident me vdekje" sipas të cilit, raportohej se një 60 vjeçar humbi jetën gjatë një aksidenti automobilistik.

Pas shqyrtimit të videos, Këshilli i Ankesave vërejtë se pamjet e transmetuara në edicionin e lajmeve ishin të rënda dhe nuk duhet të ishin emetuar pa shfrytëzuar një sistem kontrolli, gjë që në këtë rast do të shërbente kalimi i një filtri. Shfaqja e trupit të viktimës nuk është etike dhe profesionale si dhe përbën cenim të parimeve themelore të Kodit të Transmetimit. Kujtojmë se në Kodin e Transmetimit Seksioni 1 Parimet Themelore, pika 1.7 dhe në Seksionin 4 Transmetimi i Programeve Informative, pika 4.17, thuhet se "OSHMA-të duhet të marrin në konsideratë ndjeshmërinë e publikut në rastet e fatkeqësive, katastrofave, aksidenteve, duke i dhënë përparësi operacioneve të shpëtimit dhe jo pamjeve të rënda e të dhunshme".

Bazuar sa më sipër Këshilli i Ankesave pranë AMA-s vendosi të tërheqë vëmendjen duke kërkuar bashkëpunimin e stafit të Fax News Tv që Kodi i Transmetimit të ndiqet me kujdes. Çdo raportim i ngjashëm në të ardhmen duhet të ketë parasysh normat dhe rregullat etike që përmban Kodi i Transmetimit, për një raportim sa më drejtë të ngjarjeve të cilat përbëjnë ndjeshmëri tek opinioni publik.

3

Ankesa me
subjekt
komunikimet
me natyrë
tregtare

Ankesa e paraqitur nga:

Shoqëria "Dompéfarmaceutici" S.p.a

Subjekti audioviziv	Programi	Data
Televizioni News 24 Shoqëria "Media Vizion" Sh.a.	Reklamë Reklamë	17.10.2017 17.10.2017

1. Programi

Ankesa lidhet me shfaqjen e një reklame të një medikamenti, për të cilin pretendohet se nuk mund të shitet pa recetë e mjekut. Objekti i ankesës është ndalimi i dhënies së kësaj reklame.

2. Kategoria

Ankesa parashtrohet mbi parimet e Ligjit Nr. 97/ 2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nenit 42, pika 6, ligjit "Për Barnat", si dhe mbi Kodin e Transmetimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

3. Përmbledhja e ankesës

Në vijim të komunikimit me Autoritetin e Medias Audiovizive, shoqëria "Dompé farmaceutici" S.p.a informon se edhe dy operatorë të tjerë televizivë po transmetonin

reklamë mbi produktin farmaceutik FANS 80 mg, granulë për tretësirë orale. Në ankesën drejtuar AMA-s, kjo shoqëri evidenton se ky produkt duhet të shihet vetëm me recetën e mjekut. Shoqëria konstatonte se Ligji nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nenit 42, pika 6, parashikon që "Komunikimet me natyrë tregtare në transmetimet audiovizive për produktet farmaceutike ose trajtime mjekësore, që jepen vetëm me recetën e mjekut, janë të ndaluara".

Gjithashtu, shoqëria farmaceutike rithekson se është e shqetësuar që pacientët mund të ekspozohen ndaj rreziqeve të sigurisë, për shkak të informacionit të reklamës, duke qenë se ky informacion nuk është në përputhje me atë që autorizohet për produktin, çka mund të ndikojë gjithashtu negativisht në perceptimin e profilit të sigurisë dhe efikasitetit të produktit referencë të barit edhe në tregtimin e tij.

4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Me marrjen e kësaj Ankesë, Këshilli i Ankesave pranë AMA-s, që edhe më parë kishte trajtuar një ankesë të ngjashme për një tjetër OSHMA, iu drejtua me një kërkesë Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM), për informacion më të zgjeruar për produktin FANS, sipas përcaktimeve specifike në shkresën e shoqërisë "Dompéfarmaceutici".

Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore vuri në dijeni AMA-n se të dhënat e përditësuara mbi barnat e autorizuara për tregtim në Republikën e Shqipërisë gjenden në faqen zyrtare të Agjencisë; akbpm.gov.al në rubrikën "Regjistri i barnave".

Sipas regjistrimit, produkti FANS, Granula për tretësirë orale x 80 mg, ketoprofen lizinë, ka si zotërues shoqërinë "DompeFarmaceutici",

dhe është i pajisur me autorizim tregtimi me nr. 402/22.09.2014. Ky produkt nuk është pjesë e listës së barnave që jepet pa recetë. Lista gjendet në rubrikën "Publikime", në adresën www.akbpm.gov.al.

Për sa më sipër, nisur edhe nga vendimmarrja e mëparshme, bazuar në nenin 42 të Ligjit 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, pika 6, ku thuhet se "Komunikimet me natyrë tregtare në transmetimet audiovizive për produktet farmaceutike ose trajtimet që jepen vetëm me recetën e mjekut, janë të ndaluara", Autoriteti i Mediave Audiovizive u kërkoi operatorëve televizivë heqjen e menjëhershme nga transmetimi të reklamës për produktin farmaceutik ANS, granulë për tretësirë orale x 80 mg.

Ankesa e paraqitur nga: **Individ**

Subjekti audioviziv	Programi	Data
Televizioni Klan	Emisioni "Zonë e Lirë"	27.10.2017

1. Programi

Ankesa lidhet me shkeljen e dispozitave të Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në emisionin "Zonë e Lirë, një emision argëtues i formatit talk-show, të datës 27.10.2017.

2. Kategoria

Ankesa bazohet në Ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe më konkretisht në përkufizimet për komunikimet audiovizive me natyrë tregtare.

3. Përmbledhja e ankesës

Pas marrjes së ankesës në fjalë, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive vëzhgoi emisionin "Zonë e lirë", të transmetuar në Televizionin Klan, më datë 27.10.2017. Gjatë këtij emisioni u transmetua një intervistë me dy kirurgë të një spitali privat në Shqipëri, në intervalin kohor 23:12-23:40. Intervista në fjalë ishte në shkelje të Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, pasi ishte një reklamë e qartë që transmetohej brenda emisionit.

4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave mori në shqyrtim materialin përkatës filmik dhe konstatoi

shkelje të kërkesave të Ligjit nr. 97/2013 2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Intervista me dy kirurgë të një spitali privat në Shqipëri, në thelbin e saj, është reklamë e paidentifikuar. Ligji nr. 97/2013, i ndryshuar, në pikën 8 të nenin 3 të tij, përcakton qartësisht llojet e reklamave. Format e komunikimeve audiovizive me natyrë tregtare janë:

- reklamata në shërbimet audiovizive;
- sponsorizimet;
- shitjet e drejtpërdrejta;
- dritaret e teleshitjeve;
- vendosja e produkteve në programe.

Këshilli i Ankesave çmoi se, intervista me dy kirurgët nuk përfshihet në asnjë prej përkufizimeve të mësipërme. Ajo duhej transmetuar jashtë emisionit, në përputhje me kërkesat e nenit 43 të Ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar. Në pikën 1 të këtij neni thuhet: "Reklama dhe shitjet e drejtpërdrejta duhet të jenë të dallueshme dhe të veçanta nga përmbajtja tjetër që është nën përgjegjësinë editoriale dhe të veçohen nga pjesa tjetër e përmbajtjes së programit edhe kur mund të transmetohen njëkohësisht, nëpërmjet mënyrave pamore dhe/ose zanore dhe/ose ndarjes së hapësirës së tyre në ekran".

Për sa më sipër, Ama vendosi t'i tërheqë vëmendjen operatorit televiziv në fjalë për të mos përsëritur raste të tilla që bien ndesh me Ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe të heqë heqë videon përkatëse nga kanali zyrtar në Youtube.

Ankesa e paraqitur nga: **Reagime dhe shqetësime në rrjete sociale**

Subjekti audioviziv	Programi
TV Klan Top Channel Vizion Plus ABCNEWS	Reklamë me natyrë tregtare

1. Programi

Reagimet dhe shqetësimet e shprehura në rrjete të ndryshme sociale lidhen me transmetimin në disa televizione të një reklame mbi medikamentin "Brufen". Ankuesit pretendojnë se pamjet e reklamës janë "tepër shqetësuese" dhe se "fabula e reklamës paraqet një nga torturat më çnjerëzore të përdorura në mesjetë, si formë ndëshkimi për kriminelët".

2. Kategoria

Ankesa bazohet në Ligjin 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 46, pika dh), sipas së cilës, "në çështjet që përfshijnë moralin dhe etikën në materialet programore, veçanërisht paraqitja e sjelljeve të dhunshme dhe seksuale, të realizohet me kujdesin e duhurndaj ndjeshmërisë të publikut dhe efekteve të programeve të tilla në zhvillimin moral, mendore fizik të të miturve...".

3. Përmbledhja e ankesave

Reagimet, në thelb, shprehin shqetësimin se reklama për produktin farmaceutik "Brufen" përmban elementë shqetësues për publikun, video dhe audio. Edhe pse fabula e reklamës është në funksion të qëllimit të saj, duke sugjeruar medikamentin për t'u dhënë fund "torturave të dhimbjes", vetë reklama në tërësinë e saj ka ekzagjerime të dukshme, në zë dhe figurë, që krijojnë shqetësime për shikuesit apo dëgjuesit. Ankuesit e shumë

kërkuan ndërprerjen e transmetimit të reklamës në fjalë.

4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mori në shqyrtim përmbajtjen e reklamës përkatëse dhe konstatoi se:

- pavarësisht që reklama për medikamentin "Brufen" nuk është prodhim shqiptar; ajo është e njëjtë me reklamën që transmetohet në disa vende të rajonit, me ndryshimin e vetëm që transmetimi i saj në Shqipëri është i përkthyer në gjuhën shqipe;
- pavarësisht se fabula e reklamës është në funksion të qëllimit të saj, duke sugjeruar medikamentin për t'u dhënë fund "torturave të dhimbjes" dhe "për ta gëzuar jetën pa torturë";
- referuar Ligjit 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 46, pika dh), ka hapësira për të ndërhyrë në shmangien e pasazheve që paraqesin skena dhune të skajshme dhe artificiale. Në këto kushte, iu kërkua kompanisë "AbbottLaboratories", përgjegjëse për reklamën në fjalë të ndërhynte në përmbajtjen e reklamës dhe të ofronte një version tjetër të saj, në përputhje me kërkesat e legjislationit në fuqi, ose të ndërpriste transmetimin e saj. Kompania "AbbottLaboratories" u tregua mirëkuptuese dhe bashkëpunuese me AMA-n dhe vendosi heqjen e menjëhershme nga transmetimi në të gjitha televizionet të reklamës për produktin farmaceutik "Brufen".



Ankesa të
tjera

Ankesa e paraqitur nga: **shtetasi S.G.**

Subjekti audioviziv	Programi	Data
Top Channel Klan Tv ABCNews Ora News News 24 Report TV	Aksesi	03.08. 2017

1. Programi

Ankesa e qytetarit A.H. lidhet me procesin e digjitalizimit në Qarkun e Beratit pasi sipas tij ka probleme në aksesin e kanaleve të lira si dhe pajisjen me dekoderave për akses të sinjalit.

2. Kategoria

Ankesa ngrihet mbi bazën e parimeve të sanksionuara në Ligjin Nr.97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë" dhe të Strategjisë së Digjitalizimit.

3. Përmbledhje e Ankesës

Këshilli i Ankesave mori në shqyrtim ankesën e qytetarit i cili pretendonte se nuk kishte sinjal televiziv në banesën e tij si dhe për faktin e pajisjes me dekoder të përshtatshëm.

4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave kontaktoi me Departamentin Teknik të AMA-s dhe na u këshillua kjo përgjigje si më poshtë;

- Procesi i digjitalizimit, i cili ka ardhur si pasoje e zhvillimeve teknologjike dhe kërkesës në rritje për përdorim sa më efektiv të spektrit të frekuencave, është

një proces që është zhvilluar në të gjithë botën dhe Shqipëria është ndër vendet e fundit që po e implementon këtë proces. Procesi i digjitalizimit nënkupton mbylljen e transmetimeve analoge dhe kalimin në transmetime numerike duke bërë të mundur që teleshikuesit të vijnë në shohin kanalet e lira si me parë.

- Edhe në Shqipëri si në të gjithë vendet e tjera të botës për të aksesuar transmetimet numerike (të lira apo me pagesë) nevojitet pajisja marrëse (dekoderi). Dekoderat mund t'i merrni në çdo pikë shitje ku tregtohen pajisjet televizive (si antena, kablllo etj), vetëm duhet të mbani parasysht që të jenë të tipit universal DVB-T2. Qeveria shqiptare dhe jo AMA ka vendosur subvencionimin e pajisjeve marrëse (dekoderave) vetëm për familjet që marrin ndihmë ekonomike nga shteti.
- Aktualisht në qarkun e Beratit transmetohen 19 kanale të lira (referojuni faqes së AMA në linkun <http://ama.gov.al/preview/fillon-me-sukses-procesi-i-digjitalizimit-ne-qarkun-e-beratit/>).

Për informacione të mëtejshme mund të kontaktoni në numrin Call Center të AMA-s 04 410 4456 ose në numrin 069 36 56732 në të cilin do të përgjigjet grupi teknik i RTSH-se i ngritur posaçërisht për t'i ardhur në ndihmë publikut të qarkut Berat.

Ankesa e paraqitur nga: **Individ**

Dërguar në: **info@ama.gov.al**

Subjekti audioviziv	Programi	Data
Abcom	-----	28.09.2017

1. Kategoria

Ankuesi pretendon se kompania Abcomi detyron klientët e saj që kanalet televizive kombëtare, si Top Channel dhe Klan t'i shikojnë vetëm nëse abonohen në platformën Digitalb dhe jo me paketa të tjera të vetë kompanisë Abcom.

2. Përmbledhja e ankesës

Sipas ankuesit, i cili i referohet përvojës në Itali, kanalet televizive kombëtare shikohen falas (free) dhe pa dekoder, ndërsa në Shqipëri paguhet për t'i parë kanalet kombëtare. Ankuesi pretendon se, kompania Abcom i detyron klientët e saj që kanalet televizive kombëtare, si Top Channel dhe Klan t'i shikojnë vetëm nëse abonohen në platformën Digitalb dhe jo me paketa të tjera të vetë kompanisë Abcom.

3. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Kompania "AbCom" është autorizuar pranë AMA-s si subjekt Ofrues i Shërbimeve Mediatike Audiovizive (OSHMA) për përsëritjen e shërbimeve audiovizive të të tretëve të mbështetur në rrjet kabllor. Për

rrjedhje, bazuar në aktet normative që rregullojnë fushën e mediave audiovizive në Republikën e Shqipërisë, subjekti në fjalë (Abcom) ka detyrimin që të përsërisë programet (kanalet) e subjekteve të tretë vetëm nëse ka nënshkruar më parë një marrëveshje për të drejtat e transmetimit me mbajtësit e këtyre të drejtave. Nga ky detyrim nuk përjashtohen kanalet kombëtare. Në lidhje me kanalet kombëtare sqarojmë se, transmetimi i tyre pa pagesë (free) është një detyrim që kanë vetë kanalet kombëtare, por në rast se një subjekt tjetër privat dëshiron të ketë në platformën e tij një ose disa kanale kombëtare, këtë duhet ta bëjë në bazë të një marrëveshjeje private tregtare me mbajtësin ose mbajtësit e së drejtës përkatëse të transmetimit. Transmetimi pa pagesë ose jo nga këto subjekte mbetet në diskrecion të tyre, por nuk është një detyrim ligjor.

Aktualisht, të gjitha kanalet kombëtare të licencuara në territorin e Republikës së Shqipërisë mund të shikohen pa pagesë në transmetimet analoge për qarqet ku ende nuk është mbyllur procesi i digjitalizimit, si dhe në transmetimet tokësore numerike në qarqet ku procesi i digjitalizimit është mbyllur.

5

Ankesat
e rrëzuarra

Ankesa e paraqitur nga: **Znj. H.Z.**

Subjekti audioviziv	Programi	Data
Televizioni News 24	Edicion Informativ	16.10.2017

1. Programi

Ankesa lidhet me përmbushjen e një detyrimi ligjor nga një subjekte audioviziv, që transmeton edicione informative 24 orë në 24. Objekti mbi të cilin ngrihet ankesa është vënia në dispozicion të kërkueses e regjistrimit të edicionit qendror të lajmeve, të datës 23.09.2014.

2. Kategoria

Kërkesa bazohet në Ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, e më konkretisht, nenit 37 të tij.

3. Përmbledhja e ankesës

Zonja H.Z. i ka kërkuar Televizionit Neës 24 regjistrimin e edicionit qendror të lajmeve, të transmetuar nga ky televizion më datë 23.09.2014, në orën 10.00. Regjistrimi i kërkuar prej saj ishte pjesë e kërkesave të një procesi gjyqësor, ku zonja H.Z. ishte palë.

Pas shkëmbimeve shkresore midis kërkueses, televizionit dhe gjykatës, H.Z. iu drejtua Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), të cilit i kërkoi të detyronte operatorin televiziv në fjalë të përmbushte detyrimin ligjor, sipas Ligjit 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

4. Vendimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mori kërkesën e zonjës

H.Z. dhe i dërgoi përgjigjen e mëposhtme: "Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive ka marrë më datë 12.06.2017 një kërkesë nga ana Juaj, përmes së cilës kërkoni nga subjekti audioviziv privat vendor "News 24", të përmbushë detyrimin ligjor për t'ju vendosur në dispozicion regjistrimin e edicionit qendror të lajmeve, të orës 19.30, të datës 23.09.2014. Ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", neni 37, "Regjistrimi i transmetimeve", pika 1 përcakton se "OSHMA-ja, me mjetet e pajisjet e veta dhe në një mënyrë të përcaktuar për këtë qëllim nga AMA, duhet të mbajë katalogun e programeve dhe të regjistrojë çdo transmetim apo program të ofruar prej tij, në përputhje me licencën".

Në pikën 2 të nenit përcaktohet qartësisht se "Regjistrimet e bëra në përputhje me pikën 1 të këtij neni duhet të ruhen nga OSHMA-ja për një periudhë 3-mujore".

Në rast ankese, neni 52 i Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" rregullon afatet ligjore të ruajtjes së transmetimeve. Konkretisht, pika 2 e këtij neni kërkon që "Ankesa duhet të paraqitet në formë të shkruar në Këshillin e Ankesave brenda 30 ditëve nga data e transmetimit, ose kur në rastin e dyose më shumë transmetimeve të lidhura me njëra-tjetrën, nga data e transmetimit më të vonë".

Bazuar sa më sipër, kërkesa Juaj është jashtë afateve të përcaktuara nga ligji'.

Fund

**AUTORITETI I
MEDIAVE
AUDIOVIZIVE**

Adresa: Rruga "Papa Gjon Pali II",
Nr. 15, Kutia Postare 1010, Tiranë.
www.ama.gov.al

këtej, mbështetur në Kodin
të miratuar nga A
e Audiovizive i cili përm
parimet, rregullat, kërkes
e transmetimeve audioviz
ën e Shqipërisë, Këshilli i
n të vëzhgojë me kujdes se
të mirëpërcaktuara për p
të miratimit audiovizive zbatoh
i Këshillit të Ankesave i
kohësh ka qenë i mundur
audioviziv si këshillues i pë
meve audiovizive, është n
të cilin raportohen rezul
vara nëpërmjet të cilave dy
parimet, rregullat, kërkesat